



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2814/3 Prot.

Rrëshen më, 06 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 65 datë 01. 08. 2025

**PËR
EMËRTIMIN E RRUGËS “ARBËR CAKA”, QYTETI RRËSHEN, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4601, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2, të nenit nr. 11, të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2217 prot, datë 10.07.2025, bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimit në mbledhjen e datës 28.07.2025, të Komisionit Kulturës, Trashëgëmisë Kulturore, Dhënies Titujve, Emërtimeve për t’a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;*

V E N D O S I:

1. Të emërtojë rrugën “ARBËR CAKA”, qyteti Rrëshen, Njësia Administrative Rrëshen, kodit postal 4601, Bashkia Mirditë.
 - Bashkëlidhur planvendosja e rrugës në Shkallë, Sh 1: 750.
 - Rruga fillon nga degëzimi i rr. “At Gjergj Fishta 03190003”, kalon tek ish Kinemaja dhe përfundon te degëzimi i rr. “Nënë Tereza 03190038”.
 - Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 150 mL, me gjerësi kaluese prej 3.5 mL.
2. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit (D.P.Zh.T.S), të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.

3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
4. Ngarkohet, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICA KU





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2717/12 Prot.

Rrëshen më, 22 . 07 . 2025

P / V E N D I M
Nr. 66 datë 22 / 07 / 2025

PËR
EMËRTIMIN E RRUGËS NGA “PA EMËR” NË RRUGA “ARBËR CAKA”, QYTETI
RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4601, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2717 prot, datë 10/07/2025, bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak në seancë;

V E N D O S I:

1. Të emërtojë rrugën nga rruga “Pa Emër”, në rruga “ARBËR CAKA”, qyteti Rrëshen, Njësia Administrative Rrëshen, kodi postal 4601, Bashkia Mirditë.
Bashkëlidhur planvendosja e rrugës në Shkallë, Sh 1: 750.
Rruga fillon nga degëzimi i rr. “At Gjergj Fishta 03190003”, kalon tek ish Kinemaja dhe përfundon te degëzimi i rr. “Nene Tereza 03190038”.
Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 150 mL, me gjerësi kaluese prej 3.5 mL.
2. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit (D.P.Zh.T.S), të zbatojë procedurën për ndryshimin e emërimit në Gjeoportalin ASIG dhe në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA) sistemi Adresari.
3. Çdo vendim i mëparshëm që bie ndesh me parashikimet e pikës 1 të këtij vendimi shfuqizohet.

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI

Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICA KU

Paraqiti Projektin:

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit: Juljan TUSHA



Drejtoria Juridik/Prokurimeve: Manjola DODA



KRYETARI

Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2717/1 Prot.

Rrëshen më, 22 . 07 . 2025

RELACION I P/VENDIMIT

“PËR EMËRTIMIN E RRUGËS NGA “PA EMËR” NË RRUGA “ARBËR CAKA”, QYTETI RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4601, BASHKIA MIRDITË.

Drejtuar: **Anëtarëve të Këshillit bashkiak Mirditë!**

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, pika 1/1.7. shkronja “b” e nenit 54, shkronja “ll” e nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 1/1, nenit 3 të ligjit nr 9270 datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (të ndryshuar), shkronja “dh” të pikës nr. 2 të nenit nr. 11 të ligjit nr. Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në propozimin të protokolluar me shkresën nr. 2717 prot, datë 10/07/2025 të Kryetarit të bashkisë Mirditë, parashtrojmë para Jush relacionin për miratimin e P/Vendimit të sipërcituar. **Rruga fillon nga degëzimi i rr. “At Gjergj Fishta 03190003”, kalon tek ish Kinemaja dhe përfundon te degëzimi i rr. “Nene Tereza 03190038”.**

Rruga përfshirë të gjitha degëzimet në ndërtesat ekzistuese shtrihet në një gjatësi prej 176 mL, me gjerësi kaluese prej 3.5 mL.



Bashkëlidhur projekt – vendimit të paraqitur nga kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak, gjeni:

1. *Planvendosjen e rrugës;*
2. *Kërkesën e kryetarit të bashkisë;*
3. *Promemorjen e hartuar nga ing. Dod Pjetraj;*

Me respekt,

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Territorit: Juljan TUSHA

Drejtoria Juridik/Prokurimeve: Manjola DODA





Nr. 2717 Prot

BASHKIA MIRDITË

Rrëshen, më 10.07.2025

Drejtuar: **Këshillit Bashkiak Mirditë**

Të nderuar Anëtarë të Këshillit bashkiak !

Në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Mirditë i propozoj Këshillit Bashkiak Mirditë vendosjen e emrit të ndërtuesit/vëllait tonë **Arbër CAKA** të njerës prej rugeve të qytetit të Rrëshenit.

Ky propozim bazohet në kontributin profesional dhe njerezor të dhënë ndër vite si dhe vlerat e larta humane të ndërtuesit Arbër Caka.


Bashkëlidhur ju dërgoj edhe një 'Promemorie' të hartuar nga Ing. Dod Pjetraj.

Me respekt,

K R Y E T A R I

Z. Albert MËLYSHI





**ARBËR CAKA, NJË DJALË I SHKËLQYER, NJË PUNËTOR I PALODHUR,
NJË NDËRTUES ME CILËSI TË LARTË!**

Arbër Caka lindi në lagjen Dirrë, Kthellë Epër, më datë 21/08/1986. Babai i tij ishte Pal Ded Caka dhe nëna Mrika Gjon Caka nga Malaj. Ashtu si lindi në Kthellë Epër edhe punët i kishte, Të Epërme, dhe Të Epërmit e morën në gjirin e tyre, në lulen e rinisë. Arbëri ishte nip në shtëpinë e Preng Gjini Vokrrit, Malaj, e njohur për burrëri, mikpritje e bujari!

Ishte dashamiri i krejt komunitetit të Mirditës e më gjërë, dhe këtë e verteton jo vetëm puna e tij në shërbim të këtij komuniteti, por dhe pjesmarrja e madhe në ditën e varrimit të tij.

Arbëri vdiq aksidentalisht me datë 27 Tetor 2024, në Rrëshen, duke lënë në pikëllim, nënën e tij, Mrikën, vëllezërit dhe motrat, dhe gjithë të afërmit.

Nuk kishte asnjë problem nga investitorët e ndryshëm si privatë, shtetërore ose të Caritasit, që të lidhnin kontrata ndërtimi me firmën që themeloi dhe drejtonte, “Vëllezërit Caka-16” ShPK, sepse dihej se puna do të kryhej në mënyrë korrekte dhe me cilësi të lartë!

Gjithmonë i buzëqeshur, gojëmjaltë, korrekt, me asnjë mungesë në rastet e trishtimit në gjithë Mirditën, gjithmonë fjalëmbajtur, dhe një dashamirës i madh, financues i artit dhe këngëve folklorike të Mirditës. Kudo ku shkeli këmba e tij, la pas objekte të bukura dhe të forta, që qelin si lule, për tu marrë shembull! Kush nuk e ndjeu ndihmën e tij të pa interes në Mirditë, Lezhë, Mat e Kurbin? Ai bashkë me vëllezërit e tij, provoi shijen e hidhur të kurbetit, por arriti të bëhet një ndërtues duarartë dhe të shkëlqejë me firmën e tij ndërtuese kudo, bile dhe në Luginën e Preshevës ku ndërtoi dy pallate nëntë katëshe me cilësi të lartë!

Arbër Caka si drejtues ligjor i firmës “Vëllezërit Caka_-16”ShPK, ndërtoi shumë objekte disa prej të cilave, po i renditim pak a shumë në këtë memorje:

- *Banesa në Shmri të Oroshit, Fan, Prosek, Perlat, Lezhë, Kurbin etj.*
- *Banesa tip “Vilë” në Rrëshen, Vaushkhezë, Bungaj, Tale, Shënkoll, Lezhë etj*
- *Shtesa katesh në Vaushkhezë, Lezhë, Laç etj.*
- *Ndërtime infrastrukturore për vaditjen si “Kanali vaditës Malaj-Bungaj” si nënkontraktor, duke u falenderuar për punën e mirë të bërë nga Ambasadorët e Austrisë dhe Zvicrës, të akredituar në Shqipëri, pas vizitës në vend.*
- *Ndërtime për agroturizmin, si në Ndërfanë [diga liqenit], Perlat, Bulshar etj.*
- *Punime mure mbajtëse, gërmime, rrugë e breza, për likujdimin e pasojave të tërmetit në Rrëshen.*
- *Punime riparimesh dhe ndihma për kishat katolike në Mirditë.*
- *Lokale dhe banesa në Lezhë.*
- *Dy pallate nëntë katëshe në Preshevë-Bujanovc në Republikën e Serbisë.*
- *Ura me hapësirë drite 6-8 ml në Katundin e Vjetër, Fan etj.*
- *Rikonstruksion kulle në Bruq, Mat investim i Caritasit dhe ndihmë direkte e Arbërit për ta përfunduar!*
- *Bojatisje dhe riparime qendre shëndetësore Rrëshen.*
- *Riparime të rrugëve ngado që ka ndërtuar si në Malaj, Prosek, Fan, Bruq etj.*

Lista e punëve të tij do ishte shumë e gjatë por ne po ndalemi këtu! **Pa dyshim ai do mbetet një pikë referimi, për ndërtuesit e çdo firme, për cilësinë e lartë, korrektesën dhe zbatimin e afateve të ndërtimit!**

Me gjithë punët e kryera, Arbëri nuk reshti kurrë dashurinë për nënën e tij, vëllezërit e motrat, dajat e tij si dhe babain e tij në amësim, axhat dhe gjithë dashamirët që e kujtojnë me shumë nostalgji!

Dihet se meteorët shkëlqejnë shumë dhe shuhën shpejt! Qiellin e Mirditës, e përshkoi shumë shpejt Arbër Pal Caka dhe, u shua, për të mbetur i ndezur në mendjet dhe zemrat e njerzve!

ING. DOD PJETRAJ